



BASHKIA KLOS

Statistikat vendore

Kompetencat

Specialist i Statistikave është përgjegjës për:

- Identifikimin e mundësive për krijimin e një klime të favorshme për biznesin e vogël e mesëm.
- Analizimin e informacioneve ekonomike lidhur me planifikimin, shpërndarjen dhe përmirësimin e shërbimeve mbështetëse për biznesin.
- Raportimin për situatën ekonomike ,sociale, kulturore në sektorët përgjegjëse, brenda dhe jashtë bashkisë.
- Krijimin dhe mbajtjen e kontakte të vazhdueshme me zyrat analoge pranë institucioneve të tjera (INSTAT) ,organizma të huaj e subjekte privat etj.
- Grumbullimin e informacionit nga Njësitë Administrative për efekte statistikore dhe informimi.
- Grumbullimin në mënyrë periodike (1,3,6,9,12) mujore të të dhënave nga drejtoritë e Bashkisë për efekt informimi.
- Studimin e tregut të punës dhe mundësitë për punësim të banorëve të Bashkisë.
- Krijimin dhe ofrimin e instrumentave me karakter informues.

- **Struktura përgjegjëse**

Bashkia Klos ka nje specialist që mbulon Statistikat, që ushtron kompetencat e mësipërme në varësi të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike.

- **Statistika të përgjithshme**

Bashkia Klos me planin e ri territorial të miratuar më 31 korrik 2014 nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në

Republikën e Shqipërisë”, mbulon 4 njësi administrative (**Klos, Suç, Xibër, Gurrë**). me një sipërfaqe totale 351.7 km² .

Sipas të dhënave të Gjendjes Civile, Bashkia Klos ka 20.393 banorë, nga të cilët 2.036 individë banojnë në *njësinë administrative Klos dhe* 18.357 individë banojnë në *njësitë e tjera administrative*.